



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 4607 prot.

Himarë, më 23.06.2025

VENDIM

Nr. 15, datë 23.06.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 3, DATË 18.02.2025 TË KRYETARIT
TË BASHKISË “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN
CIVIL, PËR VITIN 2025“**

Në zbatim të nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, vendimit nr. 2, datë 31.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Himarë “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2025”, si dhe vendimit nr. 14, datë 02.06.2025 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e Bashkisë Himarë për vitin 2025”,

VENDOSA :

1. Në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2025 të miratuar me anë të vendimit nr. 3, datë 18.02.2025, të shtohen edhe pozicionet e punës sipas listës së mëposhtme në zbatim të ndryshimeve të bëra në strukturën e Bashkisë Himarë me anë të vendimit nr. 14, datë 02.06.2025 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e Bashkisë Himarë për vitin 2025”,

Nr. Rendor	Kategoria	Numri i vendeve vakante	Kategoria	Klasa
	Nëpunës civil i kategorisë së mesëm drejtues			
1	Drejtor i drejtorisë së të ardhurave	1 (një)	II	II-2
	Nëpunës civil i kategorisë së ulët drejtues			

2	Përgjegjës sektori, në sektorin e kontrollit dhe vlerësimit	1 (një)	III	III-2
3	Përgjegjës sektori, në sektorin e financës	1 (një)	III	III-2
4	Përgjegjës sektori, në sektorin e planifikimit të buxhetit	1 (një)	III	III-2
5	Përgjegjës sektori, në sektorin e shërbimeve digjitale	1 (një)	III	III-2
	Nëpunës civil të kategorisë ekzekutive			
6	Specialist auditues i brendshëm	1 (një)	IV	IV-3
7	Specialist jurist i gjyqësorit	1 (një)	IV	IV-3
8	Specialist i arsimit dhe rinisë	1 (një)	IV	IV-3
9	Specialist i shërbimit social	1 (një)	IV	IV-3
10	Inspektor kontrolli dhe vlerësimi	1 (një)	IV	IV-3

- Ngarkohet drejtorja e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale për publikimin e këtij plani në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të Bashkisë Himarë dhe në këndet e publikimeve në Bashkinë Himarë dhe në dy njësitë administrative Horë – Vranisht dhe Lukovë.
- Ngarkohet drejtorja e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale të fillojë kryerjen e procedurave të rekrutimit pas publikimit të këtij plani pranimesh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Vangjel Tavo

